



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

PROPOZIMET E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL
TË PUNËS PËR TË DREJTËN E VOTËS TË
SHTETASVE SHQIPTARË JASHTË VENDIT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PËR
KOMISIONIN E REFORMËS ZGJEDHORE



PËRMBAJTJA

URDHËR Nr.124 , datë 18.9.2019 PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR HARTIMIN E PAKETËS LIGJORE PËR GARANTIMIN E TË DREJTËS SË VOTËS PËR SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË..... 3

SHKRESA DËRGUIAR KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR REFORMËN ZGJEDHORE ME PROPOZIMET E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR HARTIMIN E PAKETËS LIGJORE PËR GARANTIMIN E TË DREJTËS SË VOTËS PËR SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 5

PROPOZIME PËR NDRYSHIMIN E KODIT ZGJEDHOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PA NDRYSHIME NË KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË..... 6



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

U R D H Ë R

Nr.124,datë 18.9.2019

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR HARTIMIN E
PAKETËS LIGJORE PËR GARANTIMIN E TË DREJTËS SË VOTËS PËR
SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të shkronjës “f”, të pikës 3, të vendimit nr.510, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Diasporën”,

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të tij të ketë anëtarë, përfaqësues nga institucionet, si më poshtë vijon:
 - a) Ministria e Brendshme;
 - b) Ministria e Drejtësisë;
 - c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
 - ç) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - d) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - dh) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
 - e) Instituti i Statistikave.
3. Grupi ndërinstitucional i punës të bashkëpunojë me Komisionin e Reformës Zgjedhore në Kuvendin e Shqipërisë. Ai koordinon punën me Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe u përgjigjet në emër të Kryeministrit kërkesave të punës bashkëpunuese, të cilat lidhen me realizimin e qëllimit të këtij urdhri.
4. Metodologjia e hartimit të paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bazohet në rekomandimet e Bashkimit Evropian për këtë qëllim, si dhe në praktikatat dhe modelet më të mira të vendeve anëtare të tij.



5. Në hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, grupi ndërinstytucional i punës mund të kryejë konsultime e të marrë mbështetje nga përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë të jashtëm apo përfaqësues të organizatave ndërkombëtare.
6. Paketa me ndryshime ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të hartohet e të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave, brenda muajit dhjetor 2019.
7. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, të dërgojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, emrat e përfaqësuesve të tyre pranë ministrit të Shtetit për Diasporën.
8. Ngarkohet ministri i Shtetit për Diasporën që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit ndërinstytucional të punës.
9. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe të gjitha institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN**

Nr. 6223/1 Prot.

Tiranë, më 17.12.2019

LËNDA: Dërgimi i propozimeve të Grupit Ndërinstitucional të Punës për të drejtën e votës në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë

**Z. DAMIAN GJIKNURI
KOMISIONI I POSAÇËM PËR REFORMEN ZGJEDHORE**

**ZNJ. RUDINA HAJDARI
KOMISIONI I POSAÇËM PËR REFORMËN ZGJEDHORE**

Në vlerësim të vendimarrjes së Komisionit të Reformës Zgjedhore të Kuvendit të Shqipërisë ju përcjellim propozimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Ky grup pune është ngritur me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 124, Datë 18,09.2019, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë"

Grupi ndërinstitucional i punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ka propozuar një alternativë juridike, bazuar mbi modelet funksionale, të cilat mund të realizohen pa ndryshime kushtetuese,

Theksoj se propozimet e këtij grupi ndërinstitucional pune nuk mund të jenë shteruese, por duhen konsideruar si ndihmuese për vendimarrjen e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore të ngritur me Vendimin Nr 102/2017 të Kuvendit të Shqipërisë.

Në çdo rast. jemi të gatshëm ndaj kërkesave në funksion të vendimarrjes suaj.

**PANDELI MAJKO
MINISTËR**



**PROPOZIME
PËR NDRYSHIMIN**

E

KODIT ZGJEDHOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Miratuar me Ligjin Nr.10019, Datë 29.12.2008, dhe ndryshuar me

Ligjin Nr.74/2012, Datë 19.07.2012 dhe Ligjin Nr. 31/2015, Datë 02.04.2015)

1. Në nenin 1:

- Pas pikës 1 të shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“Ky kod ka për qëllim përcaktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë dhe referendumet për zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

- Në gërmën “e”, të pikës 2, të nenit 1, të shtohet togfjalëshi “ për votimin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

2. Në nenin 2

- **Pika 7** të riformulohet si më poshtë vijon:

“**KQZ**” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod.”

- **Pika 9** të riformulohet si më poshtë vijon:

“ Listat e zgjedhësve ndahen në dy kategori: ”

i Listat e zgjedhësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat burojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes civile për çdo zonë të qendrës së votimit, të hartuara në përputhje me këtë Kod.

ii Listat e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë që burojnë nga shprehja e vullnetit të zgjedhësit në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë Kod.



- Në nenin 2, të shtohen, pika 26 ,27, 28, 29, 30, 31 dhe 32 me përmbajtjen si më poshtë:

Pika 26

“**Zgjedhës brenda territorit të Republikës së Shqipërisë**”, është votuesi me vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Pika 27

“**Zgjedhës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**” janë shtetasit shqiptarë, që kanë shprehur paraprakisht vullnetin për të ushtruar të drejtën e votës jashtë vendit dhe janë pjesë e listës së zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Pika 28

“**Shprehja e vullnetit**” është procesi me anë të së cilit zgjedhësi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë konfirmon sipas procedurës përkatëse se do të ushtrojë të drejtën e tij për të votuar jashtë vendit.”

Pika 29

“**Zarf zgjedhor**”, është materiali zgjedhor që i dërgohet shtetasit shqiptar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përgjigje të shprehjes së tij të vullnetit për të zgjedhur, i cili përmban fletët e votimit dhe udhëzimet për mënyrën e votimit në zgjedhjet përkatëse.”

Pika 30

“**Zarfi i dërgimit**” është materiali i cili gjendet brenda zarfit zgjedhor dhe përdoret për postimin e fletëve të plotësuara të votimit.

Pika 31

“**Struktura administrative përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**” ngrihet brenda Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe funksionon në përputhje me këtë Kod. Kjo strukturë është përgjegjëse për administrimin e votës së shtetasve me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe referendumet.



Pika 32

“**Certifikata e zgjedhësit**” është dokumenti me anë të cilit zgjedhësi deklaron se ka ushtruar i lirë dhe nën përgjegjësinë e tij të drejtën e votës. Kjo certifikatë nënshkruhet dhe datohet nga vetë zgjedhësi.

3. Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 11/1

Koha e votimit për zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Për zgjedhësit që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, koha e votimit përcaktohet me udhëzim të KQZ-së.”

4. Në nenin 44 gërma “d” të shfuqizohet pasi bie ndesh me parimet kushtetuese ku e drejta e votës nuk kufizohet nga kriteri i vendbanimit.

5. Pas nenit 46 shtohet neni 46/1 me këtë përmbajtje :

Neni 46/1

Lista e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Lista e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është një listë e vetme për gjithë vendin dhe përmban të gjithë zgjedhësit që kanë shprehur paraprakisht vullnetin për të ushtruar të drejtën e votës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
2. Lista e zgjedhësve jashtë Republikës së Shqipërisë përmban këto elementë:
 - a) llojin e procesit zgjedhor;
 - b) emrin dhe mbiemrin e zgjedhësit;
 - c) numrin personal;
 - d) vendbanimin ose vendqëndrimin (sipas rastit);
 - e) serinë dhe numrin e dokumentit biometrik;
 - f) kodin postar të vendbanimit ose vendqëndrimit;
 - g) rubrikën për datën e regjistrimit të zarfit të jashtëm dhe datën e hedhjes/futjes së zarfit të brendshëm në kutinë e votimit nga struktura administrative përgjegjëse për administrimin e votës jashtë vendit.



3. Kriteret specifike për përfshirjen e zgjedhësve në këtë listë janë shprehja e vullnetit paraprak për ushtrimin e të drejtë për të zgjedhur, dhe deklarimi i një adrese të vlefshme për marrjen e zarfit dhe materialeve zgjedhore.
4. Lista e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë gjenerohet nga Struktura administrative përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si pjesë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe funksionon në përputhje me këtë Kod.
5. Shpallja e listës së zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë bëhet në përputhje me parashikimet ligjore të këtij Kodi dhe udhëzimet përkatëse.”
6. Titulli i **Pjesës së Nëntë** në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë ndryshohet si në vijim: "Votimi i zgjedhësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë"
7. Në **nenin 106** pas pikës 5, shtohet pika 6 me këtë përmbajtje :
"Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i dërgon zgjedhësit me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka shprehur vullnetin për të votuar, nëpërmjet operatorit postar zarfin zgjedhor që përmban fletët e votimit bashkë me udhëzimet për procesin e votimit. Zgjedhësi ushtron të drejtën e votës duke e plotësuar dhe postuar zarfin zgjedhor brenda afateve të përcaktuara në udhëzimet e KQZ".
8. **Titulli i nenit 116** ndryshon si në vijim: “Numërimi i votave të zgjedhësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”
9. **Pas nenit 116 shtohet nenit 116/1** me këtë përmbajtje:

“Neni 116/1

Numërimi i votave të zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. KQZ është përgjegjëse për administrimin e votave të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Struktura administrative përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve jashtë Republikës së Shqipërisë administron dhe numëron votën sipas udhëzimeve të KQZ-së



10. **Neni 116/1** me titull “Hapja e kutive të materialeve të votimit”, bëhet **Neni 116/2**.

11. **Titulli i nenit 117** ndryshon si vijon: “Llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e votës për zgjedhësit që votojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”.

12. **Pas nenit 117 shtohet neni 117/1** me këtë përmbajtje:

“Neni 117/1

Llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e votës së zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Struktura administrative përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vlerëson vlefshmërinë e fletëve të votimit të zgjedhësit jashtë Republikës së Shqipërisë.
2. Vota në procesin zgjedhor shpallet e pavlefshme nëse:
 - a) vota është dërguar nga zgjedhësi i cili nuk ka zotësi për të vepruar ose të cilit i është refuzuar me vendim të KQZ, formulari për Regjistrim/Aplikim për të votuar nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pas shprehjes së vullnetit.
 - b) mungon dokumenti i identifikimit dhe/ose certifikata e zgjedhësit;
 - c) zarfi i dërgimit nuk është mbyllur hermetikisht ose është dëmtuar aq sa mund të cenojë integritetin e votës nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - d) në të njëjtin zarf zgjedhor janë vendosur dy ose me shumë fletë votimi;
 - dh)zarfi zgjedhor mbërrin në strukturën administrative përgjegjëse për votimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pas mbylljes së kohës së votimit të parashikuar në këtë Kod.
2. Vlerësimi i votave synon të identifikojë, sa të jetë e mundur, qëllimin e zgjedhësit. Në zbatim të këtij neni, KQZ-ja përgatit udhëzues të veçantë për të lehtësuar punën dhe unifikuar praktikën e vlerësimit të fletëve nga ana e komisioneve dhe personave të ngarkuar nga ky Kod për numërimin dhe vlerësimin e votave të zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



13. Pas pjesës nëntë (IX) të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë shtohet pjesa IX.A me përmbajtjen e mëposhtme:

PJESA IX/A

VOTIMI I ZGJEDHËSVE JASHTË TERRITORIT

TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 1

Qëllimi

Kjo pjesë e Kodit ka për qëllim të përcaktojë: mënyrën e regjistrimit të zgjedhësit që shpreh vullnetin për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe referendumet; mënyrën e votimit; trajtimin e materialit zgjedhor; si dhe numërimin e fletëvotimit të zgjedhësve që kanë votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

Neni 2

Parimet e përgjithshme

1. Zgjedhjet për zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë janë periodike dhe në përputhje me zhvillimin e zgjedhjeve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Votimi që ushtrohet nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kryhet në bazë të parimit të lirisë, fshehtësisë, barazisë, shprehjes së drejtpërdrejtë dhe të lirë të vullnetit sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.
3. Zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kanë të drejtën e vetëm një vote për çdo lloj procesi zgjedhor për Kuvendin e Shqipërisë apo referendum, në të kundërt përgjigjen penalisht.
4. Zgjedhësit mund të ushtrojnë të drejtën e votës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëse paraprakisht kanë shprehur vullnetin dhe kanë vendbanimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. E drejta e votës realizohet vetëm në bazë të shprehjes së lirë të vullnetit të zgjedhësit të interesuar.



5. Ushtrimi i të drejtës së votës për zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është falas dhe garantohet me ligj. Ai mundësohet nga operatori postar sipas parashikimeve të udhëzimeve të KQZ-së.

Neni 3

Kriteret për përfshirjen e zgjedhësit në listën e jashtme tëzgjedhësve

Kriteret për përfshirjen e një personi në listën e jashtme të zgjedhësve janë:

- (a) të ketë shtetësinë Shqiptare;
- (b) të ketë mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në datën e zgjedhjeve;
- (c) të mos jetë shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar;
- (d) të ketë vendbanim/vendqëndrim të regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Shprehja e vullnetit

1. Zgjedhësi, i cili plotëson kriteret e parashikuara në nenin 3. ka të drejtën e ushtrimit të votës, vetëm pasi ka shprehur vullnetit për të votuar.
2. Shprehja e vullnetit për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë bëhet:
 - a) duke aplikuar online nëpërmjet formularit në Platformën Elektronike në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së;
 - b) duke aplikuar në të njëjtën mënyrë pranë një përfaqësie diplomatike/konsullore të Republikës së Shqipërisë në formë elektronike, me ndihmën e personelit të konsullatës;
 - c) përmes faksit në KQZ, në numrin e shënuar në formularin për Aplikim/Shprehje vullneti për Votim jashtë Republikës së Shqipërisë.
3. Formulari i aplikimit online për shprehjen e vullnetit të zgjedhësit shoqërohet edhe me një kopje të skanuar ose fotografinë e dokumentit biometrik të identitetit dhe të dokumentit që vërteton qëndrimin dhe vendbanimin ose vendqëndrimin e ligjshëm jashtë vendit, të lëshuara nga organet kompetente.
4. Aplikimi i shprehjes së vullnetit për të votuar duhet të bëhet nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve dhe deri në datën e përcaktuar në udhëzimet përkatëse të KQZ-së.



Neni 5

Regjistrimi i zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Zgjedhësi i cili ka vendbanimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës nëpërmjet shërbimit postar duhet të regjistrohet në listat e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të shprehjes së vullnetit me kërkesën e veçantë për të marrë pjesë në procesin zgjedhor të radhës.
2. Kërkesa e cila përmban datën dhe të dhënat e zgjedhësit që shpreh vullnetin për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dërgohet pranë Strukturës administrative përgjegjëse për administrimin e votës jashtë vendit pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.
3. Kërkesa shoqërohet me kopjen e dokumentit biometrik si dhe me vërtetimin e vendbanimit jashtë vendit, ose respektivisht një kartë identiteti dhe një kopje e dokumentit që vërteton të drejtën e qëndrimit lëshuar nga autoritetet e huaja.
4. Modeli i kërkesës për të ushtruar të drejtën e votës nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet me udhëzim të KQZ-së. Elementët kryesorë që duhet të përmbajë kërkesa për votimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë janë:
 - a) llojin e procesit zgjedhor;
 - b) emrin dhe mbiemrin e zgjedhësit;
 - c) numrin personal;
 - ç) adresën e plotë të vendbanimit ose vendqëndrimit (sipas rastit);
 - d) kodin postar të vendbanimit ose vendqëndrimit;
 - dh)serinë dhe numrin e dokumentit biometrik;
 - d) data e plotësimit të kërkesës.
5. Dokumenti i identifikimit dhe leja e qëndrimit që shoqërojnë kërkesën duhet të jenë të vlefshme.
6. Regjistrimi konsiderohet i kryer kur të dhënat e kërkuara në platformën elektronike janë të plota dhe të sakta dhe në përputhje me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Verifikimi i këtyre të dhënave kryhet nga Struktura administrative përgjegjëse për administrimin e votës jashtë vendit në KQZ brenda 5 ditësh nga data e shprehjes së vullnetit të zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



7. KQZ-ja publikon listën e votuesve jashtë Republikës së Shqipërisë në faqen e saj zyrtare të internetit, 48 orë pas afatit të përmendur në pikën 6. Lista përmban vetëm të dhëna dhe informacione të përftuara nga votuesit me anë të formularëve online të shprehjes së vullnetit, për të cilat zgjedhësit kanë pranuar publikimin e tyre në bazë dhe për zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave në Republikën e Shqipërisë. Në listë, emrat e zgjedhësve që kanë shprehur interesin të votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të renditur sipas alfabetit, dhe sipas shteteve të deklaruara në adresën e vendbanimit ose vendqëndrimit të zgjedhësit jashtë Republikës së Shqipërisë.
8. KQZ – ja brenda afatit të sipërpërmendur, vendos listat elektorale të zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në dispozicion të operatorit postar të përzgjedhur prej saj.

Neni 7

Mënyra e votimit

1. Zgjedhësi, pasi ka shprehur vullnetin për të votuar, merr konfirmimin zyrtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Pas marrjes së konfirmimit zyrtar shtetasi shqiptar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ushtron të drejtën e votës sipas procedurës së mëposhtme:
 - a) merr zarfin zgjedhor brenda afateve të përcaktuara në këtë kod dhe udhëzimet e KQZ;
 - b) plotëson fletët e votimit dhe i vendos ato brenda zarfit të dërgimit;
 - c) në zarfin e dërgimit zgjedhësi gjithashtu vendos një fotokopje të dokumentit të identifikimit si dhe plotëson certifikatën e zgjedhësit;
 - d) fletët e votimit brenda zarfit zgjedhor të mbyllur hermetikisht, së bashku me kopjen e dokumentit të identitetit dhe certifikatës së zgjedhësit vendosen në zarfin e dërgimit dhe i dërgohen drejtpërdrejt KQZ nga çdo pike postare.
2. Zgjedhësi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është i detyruar t'i komunikojë menjëherë KQZ-së rreth vjedhjes, dëmtimit ose shkatërrimit të dokumenteve të sipërcituara për motive që nuk varen prej tij, si dhe në rastet kur zgjedhësi nuk ka marrë zarfin zgjedhor brenda afatit të përcaktuar në udhëzimet e KQZ-së.
3. Të gjitha rregullat dhe mënyra e votimit e detajuar përshkruhen në një udhëzim të publikuar të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.